



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive	
Nr./Br.No.	3083
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	9+10+10
Data/Datum/Date:	13.08.2024
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 25 /2024**  
**PËR KADASTRIN E PYJEVE DHE TOKËS PYJORE**

<sup>1</sup>Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr. 25/ 2024 Për Kadastrin e Pyjore dhe tokës pyjore i nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 09.08.2024

## **Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,**

Në mbështetje të nenit 23, paragrafi 4 të Ligji Nr. 08/L- 137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare, Nr. 9/ 3 Prill 2023), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/18 Nëntor 2022), si dhe nenin 9 paragrafi 2, të Rregullores (QRK) – Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtare - me datë 21.06.2024), Nxjerr:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 25 /2024 PËR KADASTRIN E PYJEVE DHE TOKËS PYJORE**

#### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet mënyra e krijimit, përmbajtjes dhe strukturës së kadastrit të pyjeve dhe tokës pyjore, menaxhimit dhe operimit të kadastrit të pyjeve dhe tokave pyjore, që përfshin përmbledhje të informacionit dhe dokumenteve mbi gjendjen natyrore, ekonomike dhe statusin e pyjeve, karakteristikat e cilësisë së pyjeve, vlerën ekonomike, vend ndodhjen dhe madhësinë e sipërfaqeve pyjore për një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe përdorim efektiv të tyre.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për Ministrinë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe institucionet tjera relevante, aktivitetet e të cilave ndërlidhen me menaxhimin, shfrytëzimin e pyjeve dhe tokave pyjore. Të dhënat gjeodezike të parcelave, pronësisë dhe sipërfaqeve të përfshira në Kadastrin e Pyjeve dhe Tokës Pyjore, bazohen në të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:
  - 1.1. KPTP – nënkupton, Kadastrën e Pyjeve dhe Tokës Pyjore;
  - 1.2. MBPZHR -nënkupton, Ministrinë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
  - 1.3. RMP – nënkupton, Regjionin menaxhues pyjor;
  - 1.4. NJMP – nënkupton, Njësinë menaxhuese pyjore;
  - 1.5. PMNJP – nënkupton, Planin e menaxhimit të njësisë pyjore;
  - 1.6. Ngastra pyjore – nënkupton, Ndarje fizike të ngastrës;
  - 1.7. Nën ngastra pyjore - nënkupton Grumbuj pyjor - njësi më të vogël të menaxhimit 0.3 ha);

- 1.8. APK- nënkupton, Agjencinë Pyjore të Kosovës;
  - 1.9. SIGJ- nënkupton, Sistemi i Informimit Gjeografik;
  - 1.10. SIPK- nënkupton, Sistemi Informativ për Pyjet e Kosovës;
  - 1.11. SKIZPK- nënkupton, Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarre Pyjore në Kosovë.
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë UA kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç përcaktohet në Ligjin Nr. 08/L- 137 për Pyjet e Kosovës.

## **KAPITULLI II**

### **ADMINISTRIMI I KADASTRËS PYJORE**

#### **Neni 4**

#### **Mbajtja dhe administrimi i Kadastrës Pyjore**

1. Kadastra pyjore, krijohet, mbahet dhe administrohet nga Agjencia Pyjore e Kosovës, dhe mban të dhënat në të gjitha nivelet e menaxhimit lidhur me:
  - 1.1. Kufijtë e pyjeve dhe tokave pyjore në pronësi shtetërore;
  - 1.2. Informacionet kryesore të fondit pyjor dhe kullosave;
  - 1.3. Aktivitetin e menaxhimit të këtij fondi, nëpërmjet përditësimit në kohë reale.
  - 1.4. Aktivitetet e shërbimeve në pyje private sipas kërkesave të pronareve.
2. Agjencia Pyjore e Kosovës krijon bazën e të dhënave sipas Sistemit të Informimit Gjeografik (SIGJ) dhe përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhënat dhe strukturat përgjegjëse për menaxhim me pyje, të përcaktuar me këtë udhëzimin administrativ.
3. Baza e të dhënave për treguesit e fondit pyjor dhe kullosave si pasuri shtetërore, është plani i menaxhimit me pyje.

#### **Neni 5**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjës për të dhënat kadastrale**

1. Ky udhëzim administrativ përcakton përmbajtjen, mënyrën e evidentimit, përditësimit dhe konsolidimit të të dhënave kadastrale për të gjitha pyjet, tokat pyjore dhe objektet në pronësi shtetërore.
2. Detyra kryesore e kadastrës së pyjeve dhe tokave pyjore është përmirësimi i vazhdueshëm i teknologjisë së hartimit, sistematizimit, ruajtjes, përditësimit dhe sigurimit të përdoruesve me informacion të besueshëm dhe të saktë rreth të dhënave që përmban. Njëkohësisht do të jetë edhe një bazë e të dhënave unike dhe qendrore me të dhënat gjeohapësinore.
3. Kadastra e pyjeve dhe tokës pyjore e ka për detyrë dhe objektiv që organeve qendrore, regjionale, dhe palëve të interesit të ju siguroj informacion mbi pyjet, të rregullon marrëdhëniet me resurset pyjore, të organizoj përdorimin racional, rikultivimin dhe mbrojtjen e pyjeve, menaxhimin pyjor, vlerësimin e aktivitetit ekonomik në tokat pyjore dhe menaxhim të regjistrimit shtetëror të të drejtave sipas ligjit në fuqi.

## KAPITULLI III

### PERMBAJTJA E KADASTRES SË PYJEVE DHE TOKAVE PYJORE

#### Neni 6

#### Kadastra e pyjeve dhe tokës pyjore përmban të dhëna

1. Kadastra e pyjeve dhe tokës pyjore përmban të dhëna zyrtare lidhur me statusin pronësor dhe juridik, fondin pyjor, vlerësimin ekonomik dhe ekologjik të pyjeve dhe tokës pyjore.
2. Të dhënat e kadastrës pyjore përbajnë të dhëna për pyjet, tokat pyjore, njësinë menaxhuese pyjore, fidanishtet pyjore, objektet farore, rrugët pyjore, trasetë e largpërçuesve, kanalet e ujit, gazit, ndërtimet në pyje dhe toka pyjore, miniera sipërfaqësore, toka pyjore publike të dhëna me qira, objektet e prodhimit të energjisë - mulli ere, panelet diellore, antena dhe instalime tjera.
3. Për lokacionin e shtrirjes, karakteristikat themelore teknike, skicën e vendit, listën e parcelave të caktuara, emrin dhe adresën e pronarit, gjatësinë dhe sipërfaqen për objektet lineare në pyje dhe toka pyjore publike siç janë:
  - 3.1. Linjat e sistemeve të telekomunikacionit;
  - 3.2. Linjat e tensionit të ulet për sinjalizim, kontrollim, komunikim të të dhënave apo qëllime të ngjashme;
  - 3.3. Linjat e tensionit të larte të energjisë elektrike;
  - 3.4. Gypat e ujësjellësve, ujitjeve dhe kanalizimet;
  - 3.5. Gypat nëpërmjet të cilave kalo ngrohja, nafta, gazi apo ndonjë material prodhues tjetër.
4. Të gjithë parcelat kadastrale të cilat kanë Kulturat pyjore ose i takojnë tokave pyjore duhet të jenë pjesë e kadastrit të pyjeve dhe tokës pyjore si parcelat me kulturat:
  31. Mal;
  32. Kullosë;
  33. Livadhe malore;
  34. Dhe klasa tjera të përdorimit të tokës.

#### Neni 7

#### Organizimi i të dhënave të kadastrës pyjore

1. Të dhënat e kadastrës pyjore sistemohen në nivel:
  - 1.1. Qendror;
  - 1.2. Regjional;
  - 1.3. Komunal;
  - 1.4. Njësisë menaxhuese pyjore;
  - 1.5. Zonës Kadastrale;
  - 1.6. Parcelës Kadastrale.

## **Neni 8**

### **Baza e te dhënave për Kadastrën e Pyjeve dhe Tokave Pyjore**

1. Kadastra pyjore do të përmbaj këto të dhëna mbi të gjitha parcelat në pronësi shtetërore që menaxhon APK-ja, si në vijim:
  - 1.1. Komunën;
  - 1.2. Zonën kadastrale;
  - 1.3. Të dhënat për parcelën si:
  - 1.4. Numrin e parcelës;
  - 1.5. Gjeometrinë e parcelës - Kufijtë të parcelës në Sistem koordinativ zyrtar;
  - 1.6. Vendin e quajtur;
  - 1.7. Sipërfaqen në (m<sup>2</sup>);
2. Të dhënat mbi shfrytëzimin – kulturës në parcelë si në vijim:
  - 1.1. Kulturën;
  - 1.2. Klasën e bonitetit;
  - 1.3. Sipërfaqen e kulturës (m<sup>2</sup>);

## **Neni 9**

### **Kadastr i shfrytëzimit sipërfaqësor të tokës pyjore publike për qëllime minerare**

1. Kadastr i shfrytëzimit sipërfaqësor i tokës pyjore publike për qëllime minerare duhet të përmbaj te dhënat për:
  - 1.1. Qëllimin e shfrytëzimit të parcelës - sipërfaqes;
  - 1.2. Numrin e Parcelës kadastrale;
  - 1.3. Sipërfaqen e kontraktuar për shfrytëzim;
  - 1.4. Skicën me koordinata përkatëse;
  - 1.5. Shfrytëzuesin;
  - 1.6. Llojin e objektit - përshkrimi materialit;
  - 1.7. Periudhën e shfrytëzimit;
  - 1.8. Planin e rikultivimit për sipërfaqën e shfrytëzuar;
  - 1.9. Kostot e planit të rivitalizimit.

## **Neni 10**

### **Kadastra e pyjeve përmban të dhënat për planet menaxhuese të pyjeve**

1. Të gjitha Njësit menaxhuese pyjore duhet të evidentohen në kadastër pyjore.
2. Të dhënat për njësinë menaxhuese pyjore NJMP janë si në vijim:
  - 2.1. Kodi i NJMP - nënkupton, Njësinë menaxhuese pyjore;

- 2.2. Kodi i RMP - nënkupton, Regjionin menaxhues pyjor;
  - 2.3. Emri i NJMP -nënkupton, Njësinë menaxhuese pyjore;
  - 2.4. Gjeometria - Kufijtë në Sistem koordinativ zyrtar;
  - 2.5. Sipërfaqja;
  - 2.6. Përshkrimi;
3. Të dhënat e planit menaxhues të njësisë pyjore PNJMP:
- 3.1. Kodi NJMP -nënkupton, Njësinë menaxhuese pyjore;
  - 3.2. Kodi i PNJMP - nënkupton, Planin e njësisë meaxhuese pyjore;
  - 3.3. Të dhënat e inventarizimit:
    - 3.3.1. Projekti i inventarizimit;
    - 3.3.2. Kompania zbatuese;
    - 3.3.3. Viti i fillimit të planit;
    - 3.3.4. Viti i përfundimit të planit menaxhues pyjor;
    - 3.3.5. Gjeometria - Kufijtë në Sistem koordinativ zyrtar;
  - 3.4. Statusi;
  - 3.5. Përshkrimi.
4. Te dhënat e ngastrës së planit në njësi menaxhuese pyjore NPNJMP janë si në vijim:
- 4.1. Kodi i PNJMP - nënkupton, Planin e njësisë meaxhuese pyjore;
  - 4.2. Kodi i Ngastrës;
  - 4.3. Gjeometria - Kufijtë në Sistem koordinativ zyrtar;
  - 4.4. Sipërfaqja;
  - 4.5. Statusi;
  - 4.6. Përshkrimi.
5. Të dhënat e nën-ngastrës së planit në njësi menaxhuese pyjore NNPJMP janë si në vijim:
- 5.1. Kodi i Ngastrës;
  - 5.2. Kodi i Nën-ngastrës;
  - 5.3. Gjeometria (Kufijtë në Sistem koordinativ zyrtar);
  - 5.4. Sipërfaqja;
  - 5.5. Të gjitha të dhënat tjera të nevojshme që i takojnë nën-ngastrës sipas “metodologjisë për plane menaxhuese të pyjeve në Kosovë” përfshirë dhe të dhënat të sipërfaqeve provë që i ka ajo nën-ngastër.
6. Të dhënat për Biodiversitetin dhe produktet tjera pyjore Jo drusore.

7. Kadastra pyjore duhet të gjeneroj marrëdhëniet e këtyre me regjistrin pronësor të parcelave kadastrale kur për çdo njësi menaxhuese, ngastër, nën-ngastër apo biodiversitetit do të dihet saktësisht se në cilat parcela kadastrale bëjnë pjesë ato.

## **KAPITULLI IV**

### **EVIDENCA E TOKËS PYJORE TË DHËNË ME QIRA**

#### **Neni 11**

##### **Evidenca e tokave pyjore publike të kontraktuara për prodhimtari bujqësore**

2. Evidence e tokave pyjore publike të kontraktuara për prodhimtari bujqësore përmban:
  - 2.1. Numër i Parcelës kadastrale;
  - 2.2. Sipërfaqen e kontraktuar për shfrytëzim;
  - 2.3. Skicën me koordinata përkatëse për parcelën në shfrytëzim;
3. Kadastra pyjore duhet të mundësoj të evidentoj dhe menaxhoj me të gjitha sipërfaqe të tokës pyjore të cilat jepen në shfrytëzim për qëllimet të prodhimtarisë bujqësore.
4. Duhet të përmbajë të dhënat:
  - 4.1. Shfrytëzuesin;
  - 4.2. Qëllimin;
  - 4.3. Kulturën për të cilën do ta shfrytëzoj;
  - 4.4. Gjeometrinë - kufirin e shfrytëzimit në sistemin koordinativ zyrtar;
  - 4.5. Sipërfaqen;
  - 4.6. Periudhën e shfrytëzimit.
5. Kadastra pyjore duhet të gjeneroj marrëdhëniet e këtyre me regjistrin pronësor të parcelave kadastrale kur për çdo sipërfaqe të dhënë me qira për qëllime bujqësore do të dihet saktësisht se në cilës parcelë kadastrale do t'i takoj dhe çfarë sipërfaqe merr nga to.
6. Kadastra pyjore duhet të mundësoj gjenerimin e marrëdhënieve të këtyre sipërfaqeve me resurset pyjore si në cilat njësi menaxhuese kalojnë, cilat ngastra, nën ngastra.

#### **Neni 12**

##### **Evidenca e objekteve të përkohshme të ndërtuara nga subjektet private sipas kontratave të qiramarrjes në toka publike**

1. Kadastra pyjore mundëson evidentimin dhe menaxhimin me të gjitha sipërfaqet e tokës pyjore të cilat jepen në shfrytëzim për qëllimet të ndërtimit të objekteve të përkohshme të ndërtuara nga subjektet private, dhe përmban të dhënat si në vijim:
  - 1.1. Shfrytëzuesin;
  - 1.2. Qëllimin;
  - 1.3. Numri i Parcelës kadastrale;

- 1.4. Llojin e objektit -përshkrimi materiali;
  - 1.5. Sipërfaqen e objektit me etazhitet;
  - 1.6. Gjeometrinë e objektet - shputën apo gjurmën e objektit në Sistemin koordinativ zyrtar;
  - 1.7. Gjeometrinë e sipërfaqes në shfrytëzim - kufirin e shfrytëzimit në sistemin koordinativ zyrtar;
  - 1.8. Sipërfaqen në shfrytëzim;
  - 1.9. Periudhën e shfrytëzimit;
  - 1.10. Plan e rigjenerimit pyjor pas shkëputjes apo përfundimit të kontratës.
  - 1.11. Kostot e planit të rivitalizimit.
2. Kadastra pyjore duhet të gjeneroj marrëdhëniet e këtyre me regjistrin pronësor të parcelave kadastrale kur për çdo sipërfaqe të dhënë me qira për qëllime të ndërtimit të objekteve të përkohshme do të dihet saktësisht se në çfarë parcelat kadastrale do të takoj dhe çfarë sipërfaqe merr nga to.
3. Kadastra pyjore duhet të mundësoj gjenerimin e marrëdhënieve të këtyre sipërfaqeve me resurset pyjore se në cilat njësi menaxhuese kalojnë, cilat ngastra, nënngastra.

### **Neni 13**

#### **Evidenca e objekteve në shërbim të menaxhimit me pyje**

1. Kadastra pyjore duhet të evidentoj dhe menaxhoj me të gjitha objektet në shërbim të menaxhimit me pyje si: zyra, depo, garazhe dhe objekte përcjellëse, reparte të përpunimit të drurit, depo të përkohshme për asortimente drusore, përmban të dhënat si në vijim:
- 1.1. Shfrytëzuesin;
  - 1.2. Qëllimin;
  - 1.3. Llojin e objektit - përshkrimi materiali;
  - 1.4. Sipërfaqen e objektit me etazhitet;
  - 1.5. Gjeometrinë e objektet - gjurmën e objektit në Sistemi koordinativ zyrtar;
  - 1.6. Gjeometrinë e sipërfaqes në shfrytëzim - kufirin e shfrytëzimit në sistemin koordinativ zyrtar;
  - 1.7. Sipërfaqen në shfrytëzim,
  - 1.8. Periudhën e shfrytëzimit,
  - 1.9. Plan rigjenerimit pyjore pas përfundimit apo ndërprerjes së kontratës.
2. Kadastra pyjore duhet të gjeneroj marrëdhëniet e këtyre me regjistrin pronësor të parcelave kadastrale kur për çdo objekt do të dihet saktësisht se cilës parcele kadastrale do t'i takoj dhe çfarë sipërfaqe merr nga to.
3. Kadastra pyjore duhet të mundësoj gjenerimin e marrëdhënieve të këtyre sipërfaqeve me resurset pyjore si, në cilat njësi menaxhuese kalojnë, cilat ngastra, nënngastra.



#### **Neni 14**

#### **Evidenca e objekteve farore të përcaktuara në bazë të rregullave të veçanta**

1. Evidenca e objekteve farore të përcaktuara në bazë të rregullave të veçanta, përmban:
  - 1.1. Numrin e Parcelës kadastrale;
  - 1.2. Numrin e ngastrës pyjore;
  - 1.3. Emri i njësisë menaxhuese;
  - 1.4. Sipërfaqen e përgjithshme;
  - 1.5. Skicën me koordinata përkatëse.

#### **Neni 15**

#### **Ndërveprimi i Kadastrës pyjore dhe tokës pyjore me sisteme tjera relevante**

1. Kadastra pyjore duhet të mundësoj ndërveprimin dhe sisteme tjera informative si:
  - 1.1. SIPK- Sistemi Informativ për Pyjet e Kosovës;
  - 1.2. SKIZPK – Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarre Pyjore në Kosovë;
  - 1.3. Gjeoportalin e Kosovës;
  - 1.4. Dhe sistemeve tjera relevante.

#### **Neni 16**

#### **Kadastru Pyjor duhet të përmbaj edhe të dhënat tjera gjeohapësinore**

1. Kadastra pyjore duhet të përmbajë edhe të dhënat tjera gjeohapësinore si:
  - 1.1. Ortofotove - të viteve të ndryshme 2004, 2009, 2012, 2018, dhe viteve në vijim;
  - 1.2. Hartave Topografike 1:25,000 të vjetra;
  - 1.3. Hartave Topografike 1:25,000 të reja;
  - 1.4. Harta Pedologjike e Republikës së Kosovës;
  - 1.5. Modele digjitale të terrenit;
  - 1.6. Modelin e Pjerrësisë së terrenit;
  - 1.7. Modelin e ekspozicionit të terrenit;
  - 1.8. Hartat mbi gjendjen dhe vlerësimin e erozionit - kategoritë e tyre;
  - 1.9. Imazhet të ndryshme satelitore të hapura;
  - 1.10. Hartave bazë të llojeve të ndryshme si (openstreetmap, OpenTopomap);
  - 1.11. Harta hidrografike (lumenjve, prockave, liqeneve, burimeve të ndryshme ujore);
  - 1.12. Harta të rrezikshmërisë (minave);
  - 1.13. Harta e vjetër të planeve menaxhuese pyjore;
  - 1.14. Të dhënat të adresave dhe rrugëve.

## **Neni 17 Organizimi**

1. Kadastra është një sistem i informatave të integruara dhe i qasshëm nëpërmjet një web portali të veçantë dhe të menaxhuar nga njësi e veçante brenda APK-së si:

- 1.1. Niveli Qendror – Njësia e IT-se dhe GIS-it MBPZHR;
- 1.2. Niveli Qendror – Njësia e IT – se dhe GIS-it APK;
- 1.3. Niveli regjional – Njësia e IT- se dhe GIS-it.

2. Qasja në sistemin e kadastrit të pyjeve dhe tokës pyjore do të bëhet në mënyrë hierarike bazuar në nivelin dhe skemës organizative të institucionit.

## **Neni 18 Moszbatimi**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenin 75 të Ligjit Nr. 08/L – 173 Për Pyjet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/3 Prill 2023).

## **Neni 19 Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas Publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Raton PEÇI**  
  
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



13/02 2024